

## NOUN PHRASE IN THE SYNTACTIC FUNCTION AS A COMPLEMENT TO THE VERB IN GERMAN AND ALBANIAN

### SINTAGMA EMËRORE NË FUNKSIONET E SAJ SINTAKSORE SI PLOTËS I FOLJES NË GJUHËN GJERMANE DHE SHQIPE

**Muarem AJDARI<sup>1</sup>, Osman ISMAILI<sup>2</sup>**

<sup>1\*</sup> *Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

<sup>2\*</sup> *Department of German Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

<sup>\*</sup> *Corresponding author e-mail: muarem.ajdari@unite.edu.mk, osman.ismaili@unite.edu.mk*

#### **Abstract**

Based on dependency grammar, the verb is the head of the sentence and it has the ability to determine the structure of the sentence, respectively to determine the necessary members of the sentence, without which the sentence would be grammatically incorrect, an ability known as valence of the verb. The sentence is built from groups of words related to each other in terms of grammar but also meaning. The group of words *das schöne Haus* 'shtëpia e bukur' in terms of the hierarchy has a noun, which stands at the highest hierarchical place and which leads it with this group of words, *haus* is therefore the head of this group of words, respectively *shtëpia*, and based on this, it is named as a *noun phrase* (Nominalphrase). Noun phrases, as a linguistic construction, depends on the verb in the sentence and based on this it can share different functions in the sentence as syntactic parts (Syntaktische Glieder). The parts of the sentence are divided into complete and circumstantial. The division is made according to the criteria of specification and necessity. A verb is specific if it occurs only in a certain subclass of verbs. As for necessity, the proof is made by removing the definite article from the sentence.

**Keywords:** dependency, head, phrase, complement, supplement.


#### **Përmbledhje**

Në bazë të gramatikës së varësisë (dependenciale) folja është koka e fjalisë dhe ajo e ka aftësinë të përcaktojë strukturën e fjalisë, respektivisht të përcaktojë gjymtyrët e domosdoshme të fjalisë, pa të cilat fjalia do të ishte gramatikisht jo korrekte, aftësi e cila njihet si valencë e foljes. Fjalia është e ndërtuar prej grupe fjalësh të lidhura mes veti për nga ana gramatikore por edhe ajo kuptimore. Grupi i fjalëve *das schöne Haus* 'shtëpia e bukur' që për nga hierarkia ka një emër, i cili qëndron në vendin më të lartë hierarkik dhe që e udhëheq me këtë grup fjalësh, *haus* është pra koka e këtij grupi fjalësh, respektivisht *shtëpia*, dhe në bazë të kësaj emërtohet si sintagmë emërore (Nominalphrase). Sintagmat emërore, si konstruksione gjuhësore, varen nga folja në fjali dhe në bazë të kësaj ajo mund t'i ndajë funksione të ndryshme në fjali si gjymtyrë sintaksore (Syntaktische Glieder). Gjymtyrët e fjalisë ndahen në plotës dhe rrethorë. Ndarja bëhet sipas kriterëve të specifikimit dhe domosdoshmërisë. Gjymtyra e fjalisë është specifike nëse shfaqet vetëm tek një nënklasë e caktuar e foljeve. Sa i përket domosdoshmërisë, prova bëhet duke e mënjanuar gjymtyrën e caktuar nga fjalia.

**Fjalët kyçe:** varësia, kokë, sintagmë, plotës, rrethorë.

## 1. Mbi sintagmat në përgjithësi

Elementi kryesor në një fjali është folja dhe sipas Engel 2009, ajo ka dy funksione esenciale. Së pari krijon fjalinë si folje në formë të shtjelluar, duke marrë qëndrim për realitetin e situatës së përshkruar dhe e dyta, si folje qendrore, përcakton plotësit dhe me atë edhe modelin e fjalisë dhe strukturën minimale të saj. (Engel 2009: 87)



Nga fjalia *Studenti i gjermanistikës nga universiteti i Tetovës shkruan një punim shkencor* del se fjalia nuk përbëhet thjeshtë nga fjalët, por nga grupet e fjalëve, të cilat edhe mund të përmbajnë në vete grupe tjera të fjalëve ose forma të vetme të fjalëve. Këto grupe fjalësh si *studenti i gjermanistikës nga universiteti i Tetovës* dhe *një punim shkencor*, varen ose **drejtohen** drejtpërdrejtë nga folja në fjali prandaj edhe emërtohen si gjymtyrë të foljes ose **gjymtyrë sintaksore** (Syntaktische Glieder - Satzglieder).

Pra, shikuar fjalinë e mësipërme nga jashtë, folja *shkruaj* ka dy gjymtyrë në këtë fjali, respektivisht dy grupe emërore: *studenti i gjermanistikës nga universiteti i Tetovës* dhe *një punim shkencor*. Nëse këto dy grupe emërore i shikojmë nga brenda mund të konstatohet dhe elementi i cili i drejton këto dy grupe të fjalëve është një emër, kështu ai e zë vendin më të lartë hierarkik në konstruksionin e dhënë gjuhësor dhe quhet kokë. Koka e karakterizon konstruksionin gjuhësor, e cila e bart emrin e këtij konstruksioni. Konstruksionet gjuhësore të emërtuara sipas kokës quhen **sintagma** (Phrasen).

## 2. Sintagmat emërore

Kur flitet për sintagmat emërore, bëhet fjalë për sintagma të cilat kokë që udhëheq e kanë një emër.

*Der Student besteht die Prüfung.* ‘Studenti e kalon provimin.’

Sintagmat emërore janë të përcaktuara gjithmonë për nga veta, numri, gjinia dhe rasa. Veta, numri dhe gjinia janë kategori, për të cilat gjithmonë është përgjegjës koka e sintagmës emërore. (Duden 2006: 810). Rasa e sintagmës emërore përcaktohet nga folja në fjali.

### 3. Funkcionet sintaksore të sintagmave emërore si plotës të foljes

Lidhur me funksionet sintaksore të sintagmave emërore si plotës të foljes do të paraqiten:

- Kryefjala (Subjekt)
- Plotësi në kallëzore/kundrina e drejtë (Akkusativergänzung)
- Plotësi në gjinore (Genitivergänzung)
- Plotësi në dhanore/kundrina e zhdrejtë (Dativergänzung)
- Plotësi ekspansiv (Expansivergänzung)
- Plotësi kallëzuesor në emërore
- Plotësi kallëzuesor në kallëzore

3.1. *Kryefjala (Subjekt)*: Kryefjala, sikur të gjithë plotësit është e varur nga folja qendrore (koka e fjalisë). Ajo është një gjymtyrë e domosdoshme e fjalisë në rasën emërore, e cila e kryen veprimin në fjali ose paraqet një gjendje të caktuar.

(1)	<i>Der Student hat die Prüfung bestanden.</i>	<b>Studenti</b> e ka kaluar provimin.
(2)	<i>Er hat die Prüfung bestanden.</i>	<b>Ai</b> e ka kaluar provimin.
(3)	<i>Dass sie heute eine neue Mütze trägt, fiel mir sofort auf</i>	Menjëherë më ra në sy <b>që ajo sot mbante një kapelë të re.</b>
(4)	<i>Sie kennenzulernen freut mich ganz besonderes.</i>	<b>---</b> Jam jashtëzakonisht i lumtur që ju njoha.
(5)	<i>Die Kinder aus der Nachbarschaft spielen auf dem Spielplatz.</i>	<b>Fëmijët e lagjes</b> luajnë në parkun e lodrave.

Tek shembujt e mësipërm (3) dhe (4) kryefjala është realizuar me fjali nënrenditëse, respektivisht në (4) me konstrukcion parafjala *zu + Infinitiv*, e që në gjuhën shqipe shihet se nuk mund të del një konstrukcion i tillë. Dhe në (3) me një *dass-Satz* (fjali me lidhëzën *dass* ‘që/se’). Të tjerat janë me sintagma emërore, respektivisht përemërore.

3.2. *Plotësi në kallëzore/kundrina e drejtë (Akkusativergänzung)*: Plotësi në rasën kallëzore është gjymtyrë e domosdoshme e fjalisë, një sintagmë emërore, ku bie veprimi i foljes. Ky plotës i përgjigjet pyetjes *kë/cilin* për njerëz dhe *çka/çfarë* për sende. Kundrina e drejtë paraqitet me këto forma:

(1)	<i>Der Student hat die Prüfung bestanden.</i>	Studenti e ka kaluar <b>provimin.</b>
(2)	<i>Er hat sie bestanden.</i>	Ai e ka kaluar <b>atë.</b>
(3)	<i>Sie weiß, dass Eva heute kommt.</i>	Ajo e di <b>që sot vjen Eva.</b>
(4)	<i>Ich verstehe nicht, was du damit sagen willst.</i>	Nuk kuptoj <b>çfarë dëshiron të thuash.</b>
(5)	<i>Anna hofft, ihn wieder zu sehen.</i>	Ana shpreson <b>ta takojë përsëri.</b>

3.3. *Plotësi në gjinore (Genitivergänzung)*: Ky plotës paraqitet vetëm tek një numër i vogël foljesh në gjuhën gjermane. Pyetja që duhet t’i përgjigjet folja është *wessen* ‘i/e/të kujt’. Disa nga foljet që në gjermanishte kërkojnë plotës në gjinore ka tendencë që të krijojnë fjali me sintagmë parafjalore sikur në (4) më poshtë. Më poshtë mund të shihet se edhe tek ekuivalencat e këtij plotësi të gjuhës gjermane ka më shumë përdorim të sintagmave parafjalore dhe atyre emërore në kallëzore.

(1)	<i>Er schämt sich seines Verhaltens.</i>	I vjen turp nga sjellja e vet.*
(2)	<i>Wir gedenken der Toten.</i>	I kujtojmë të vdekurit.*
(3)	<i>Die Polizei verdächtigt den Mann des Diebstahls.</i>	Policia e mban të dyshimtë për vjedhjen.*
(4)	<i>Ich erinnere mich der alten Zeiten. Ich erinnere mich an die alten Zeiten.</i>	Kujtoj kohërat e vjetra.*
(5)	<i>Ich erinnere mich nicht mehr, was er sagte.</i>	Nuk më kujtohet më se çfarë thoshte.*
(6)	<i>Ich erinnere mich, sie gestern beim Fest gesehen zu haben.</i>	Më kujtohet që dje e kam parë atë gjatë festës.*

Tek shembujt e mësipërm nuk mund të vërehet asnjë nga ekuivalencat në gjuhën shqipe që dalin me objekt/plotës në gjinore. Valenca e foljeve në gjuhën shqipe nuk kërkon plotës/objekt në gjinore, përveç konstruksioneve të sintagmave parafjalore me lokucione parafjalore që kërkojnë gjinoren.

3.4. Plotësi në dhanore/kundrina e zhdrejtë pa parafjalë (*Dativergänzung*) : Plotësi në rasën dhanore është gjymtyrë e domosdoshme e fjalisë, një sintagmë emërore, ku në mënyrë jo të drejtpërdrejtë bie veprimi i foljes. Ky plotës i përgjigjet pyetjes *kujt/cilit*. Kundrina e zhdrejtë paraqitet me këto forma:

(1)	<i>Der Arzt hilft dem Verletzten.</i>	Mjeku i ndihmon të lënduarit. (Mjeku e ndihmon të lënduarin.)*
(2)	<i>Der Arzt hilft ihm.</i>	Mjeku i ndihmon atij.
(3)	<i>Ich schenke meiner Schwester ein Auto.</i>	Motrës sime ia dhuroj një veturë.
(4)	<i>Ich schenke ihr ein Auto.</i>	Asaj ia dhuroj një veturë.
(5)	<i>Ich kaufe ihr ein Auto.</i>	Asaj ia blej një veturë.
(6)	<i>Mir ist das Buch runtergefallen.</i>	Mua më ka rënë libri.
(7)	<i>Pass auf, sonst fällt dir das Glas runter.</i>	Ki kujdes, përndryshe do të bie gota poshtë.

Ky plotës i foljes së gjermanishtes pothuaj se përkon plotësisht me atë të gjuhës shqipe. Mund të ketë përjashtime sa i përket valencës së foljes.

3.5. Plotës ekspansiv (*Expansivergänzung*): Paraqitet te foljet, të cilat paraqesin një ndryshim ose një shtrirje në hapësirë, kohë ose cilësi (Engel 2009: 146). Disa gramatikanë i trajtojnë këto gjymtyrë të fjalisë si rrethorë të domosdoshëm, si psh. Helbi&Buscha 2006.

(1)	<i>Die Vorlesungen dauerten neunzig Minuten.</i>	Ligjëratat zgjatën nëntëdhjetë minuta.
(2)	<i>Die Schokolade kostet einen Euro.</i>	Çokolata kushton një euro.
(3)	<i>Der Baum ist um einen Meter gewachsen.</i>	Kjo pemë është rritur për një metër.*
(4)	<i>Der Zug fährt bis Berlin.</i>	Treni shkon deri në Berlin.
(5)	<i>Er lief, bis er die Schule erreichte.</i>	Ai vrapoi, derisa arriti te shkolla.

Shumica e këtyre gjymtyrëve të fjalisë shprehen edhe me sintagma parafjalore si (20, (3) dhe (4).

### 3.6. Plotësi kallëzuesor (Prädikativergänzung):

3.6.1. Plotësi kallëzuesor në emërore (Der Prädikative Nominativ): Sintagma emërore si plotës kallëzuesor në emërore i dedikohet kryefjalës dhe ka të bëjë me foljet këpujore si *sein, werden, bleiben, scheinen, dünken, heißen*.

(1)	<i>Dieses Model ist ein Erfolg.</i>	Ky model është <b>një sukses</b> .
(2)	<i>Sie ist eine gute Managerin.</i>	Ajo është <b>një menaxhere e mirë</b> .
(3)	<i>Er heißt Jan.</i>	Ai quhet <b>Jan</b> .
(4)	<i>Hans wird Lehrer.</i>	Hansi bëhet <b>mësues</b> .
(5)	<i>Bleib, wie du immer warst.</i>	Qëndro, <b>siç ke qenë gjithmonë</b> .
(6)	<i>Ich will ja ich bleiben.</i>	Unë dua të mbetem <b>unë</b> .
(7)	<i>Sie war eine ausgezeichnete Studentin.</i>	Ajo ishte <b>një studente e shkëlqyer</b> .

3.6.2. Plotësi kallëzuesor në kallëzore (Der Prädikative Akkusativ): Sintagma emërore si plotës kallëzuesor në kallëzore i dedikohet objektit/kundrinës së drejtë dhe ka të bëjë me foljet *nennen, heißen, schelten, schimpfen, finden*.

(1)	<i>Man nannte ihn einen Profifußballer.</i>	Atë e quanin <b>futbollist profesionist</b> .
(2)	<i>Man schimpfte ihn einen Taugenichts.</i>	I shanin duke i thënë <b>përtac</b> .
(3)	<i>Sie halten ihn für einen Versager.</i>	Atë e konsideruan <b>për dështak</b> .
(4)	<i>Sie nannte ihn einen Betrüger</i>	Atë e quanin <b>mashtrues</b> .

### Përfundim

Folja është elementi kryesor në fjali. Ajo e përcakton strukturën e fjalisë prandaj mund të thuhet se është koka e fjalisë. Ajo i përcakton plotësit dhe me atë edhe strukturën e fjalisë. Grupet e fjalëve të cilat varen drejtpërdrejtë nga folja ose drejtohen nga ajo emërtohen gjymtyrë të fjalisë ose gjymtyrë sintaksore, në gjuhën gjermane (Syntaktische Glieder – Satzglieder). Grupet emërore të fjalëve drejtohen nga një emër, i cili e zë vendin më të lartë hierarkik në atë grup të fjalëve. Konstruksionet e këtilla quhen sintagma (Phrasen). Se në cilën rasë do të vendoset një sintagmë emërore në fjali varet nga folja. Ajo ia cakton funksionin në fjali.

Funksionet që sintagmat emërore i marrin në fjali mund të jenë:

- Kryefjala (Subjekt)
- Plotësi në kallëzore/kundrina e drejtë (Akkusativergänzung)
- Plotësi në gjinore (Genitivergänzung)
- Plotësi në dhanore/kundrina e zhdrejtë (Dativergänzung)
- Plotësi ekspansiv (Expansivergänzung)
- Plotësi kallëzuesor në emërore (Prädikativergänzung)
- Plotësi kallëzuesor në kallëzore (Prädikativergänzung)

Dallimi më i madh i plotësve të foljes në gjermanishte me plotësit e foljes në gjuhën shqipe paraqitet te konstruksionet e gjermanishtes me *zu + Infinitiv* dhe te *Genitivergänzung* (plotësi në gjinore).

## References

- [1]. Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, S., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafe, E., & Likaj, E. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I* (Vëll. i 1). Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë.
- [2]. Buchholz, O., & Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie.
- [3]. Bußmann, H. (2002). *Lexikon der Sprachwissenschaft*. Stuttgart: Kröner.
- [4]. Çeliku, M., Domi, M., Floqi, S., Mansaku, S., Përmasa, R., Prifti, S., & Totoni, M. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II* (Vëll. i 2). Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë.
- [5]. Demiraj, S. (1987). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
- [6]. Duden. (2003). *Deutsches Universalwörterbuch* (bot. i 5). (Dudenredaktion, Re.) Mannheim: Dudenverlag.
- [7]. Duden. (2006). *Die Grammatik* (bot. i 7, Vëll. i 4). Mannheim: Bibliographisches Institut & F.A. Brockhaus AG Mannheim.
- [8]. Eisenberg, P. (2004). *Grundriß der deutschen Grammatik* (Vëll. i 2). Stuttgart: Metzler.
- [9]. Engel, U. (1992). Der Satz und seine Bausteine. Në V. Agel, R. Hessky, V. Agel, & R. Hessky (Red.), *Offene Fragen - offene Antworten in der Sprachgermanistik* (fv. 53-76). Tübingen: Max Niemeyer Verlag.
- [10]. Engel, U. (1994). *Syntax der deutschen Gegenwartsprache*. Berlin: Schmidt.
- [11]. Engel, U. (1996). *Deutsche Grammatik* (bot. i 3., korrigierte Auflage). Heidelberg: Julius Groos Verlag.
- [12]. Engel, U. (2009). *Deutsche Grammatik - Neubearbeitung* (bot. i 2). München: IUDICIUM Verlag.
- [13]. Engel, U., & Schumacher, H. (2003). *Kleines Valenzlexikon deutscher Verben*. Mannheim: Institut für deutsche Sprache.
- [14]. Eroms, H. (2000). *Syntax der deutschen Sprache*. Berlin/New York: de Gruyter.
- [15]. Hahn, J. (1854). *Albanesische Studien*. Jena: Mauke.
- [16]. Helbig, G., & Buscha, J. (2013). *Deutsche Grammatik*. München: Klett-Langenscheidt.
- [17]. Heringer, H.-J. (1996). *Deutsche Syntax dependenziell*. Tübingen: Stauffenburg.
- [18]. Rein, K. (1983). *Einführung in die kontrastive Linguistik*. Darmstadt: Wissenschaftliche Buchgesellschaft.
- [19]. Zifonun, G., Hoffmann, L., & Strecker, B. (1997). *Grammatik der deutschen Sprache*. Berlin: de Gruyter.